

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Berisha: U deklaroj organizatave kriminale të Elb - Syri Lajmi i fundit
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919193/berisha-u-deklaroj-organizatave-kriminale-te-elbasa-nit-durresit-shkodres-dhe-mbare-shqiperise-vend-mbi-toke-nuk-do-te-keni-vec-burgut/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 17:31:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 17:03:56 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	51cb468a2adb0eead6f9d90d85cb538d320ef6f8b7c388343715037b6a0b7832
TEKSTI	77b3098f74c62dfda60f2c7136032639f111d37b0a37ebec83f19252dc6fc34a
PAMJA	704b6ecc0d42e4f768cec5d8a0375548945320642d4708fd084443fb15fd7a70

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fc6d62da404dba9642e4213302a7a7f7602fddf395904192a3f06491668c7280
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b795f32e8dcccad3401c122ecb35fb566e35fee7f00b27116f873c51e2a9a0ff8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fc6d62da404dba9642e4213302a7a7f7602fddf395904192a3f06491668c7280>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtareve

**ENVER BYTYÇI**

Vendimi i Hagës dhe raporti ynë me të vërtetën!

LAJMI I FUNDIT**LIVE/ Foltorja e Ripërtëritjes me Kryetarin e PD-së, Sali Berisha, në Elbasan****më të lexuarat**

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



Mashtrimi me shëndetësinë falas: Shqipëria e dyta në Europë për koston e lartë



Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë




'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë



Akuzat për shefen e SHSH, Ndoja: Kjo është rënia e shtetit, është bashkuar me krimin



Fati i bashkëpunëtorëve kosovarë të Ramës



Berisha: U deklaroj organizatave kriminale të Elbasanit, Durrësit, Shkodrës dhe mbarë Shqipërisë, vend mbi tokë nuk do të keni veç burgut

19:03, 25/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Kryetari i PD-së, Sali Berisha, në 'Foltoren e Ripërtëritjes' në Elbasan, deklaroi se një nga prioritetet e opozitës do të jetë lufta ndaj krimit të organizuar, ndërsa paralajmëroi masa të ashpra ndaj grupeve kriminale.

'U deklaroj organizatave kriminale të Elbasanit, të Durrësit, të Shkodrës dhe të mbarë Shqipërisë, se vend mbi tokë nuk do të keni përveç burgut', u shpreh Berisha.

Në fjalën e tij, ai premtoi gjithashtu dyfishimin e rrogave dhe pensione ve si kushtin e parë të mandatit të parë, si dhe heqjen e taksës për të gjitha ushqimet.

Berisha e cilësoi 'Ripërtëritjen' e PD-së si 'emergjencë kombëtare' dhe akuzoi qeverinë për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar.

Pjesë nga fjala e kreut të PD, Sali Berisha:

Pra këtu jemi, ndaj dhe kjo ripërtëritja jonë është jetike për ripërtëritjen e Shqipërisë. Ne kemi një vizion me të cilin do t'i japim përgjigjen më të merituar, më të sigurt, kësaj gjëme që ka pllakosur kombin tonë, kësaj varfërie, këtij mjerimi që ecën me shpejtësi.

Ne do vendosim dyfishimin e rrogave dhe të pensione ve si kushti i parë i mandatit të parë. Do heqim taksën për të gjitha ushqimet. Pa taksë. Nuk mund të ketë problem, ishte e paimagjinueshme të jetë ushqimi problem në një vend që ka pasuri përrallore si Shqipëria.

U ktheva nga Franca në vitin '78 dhe një i afërmi im më pyeti, Sali tha, si e kishin punën me ushqim? I thashë, ata nuk kishin problem ushqim. Ky u skuq. Kur unë i thashë këtë gjë.

Ky nuk mund ta imagjinonte kete. Dhe per coincidence ky njeri ma ka rikujtuar këtë skuqjen e tij edhe 25 vite mbraja. Kur ma the tha, u skuqa, nuk e besoja.

S'mund të ketë Shqipëria problem, por Shqipëria vidhet njëllor siç shkatërroreshin tre të katërtat e shtëpisë në tregimin e Dino Buxatit, që e shemben shtëpinë gjatë një vere, edhe këta të pangopur, këta zyrtarë të shpërfytyruar, pa asnjë normë morale.

Këta njerëz i kanë vjedhur qindra, qindra milionë që hyjnë dy tre vite në burg dhe dalin për të prekur milionat e tyre. Pra ripërtëritja jonë është një emergjencë kombëtare. Ne duhet të hapemi ndaj vlerave, ndaj të rinjve, ndaj zonjave dhe zonjushave.

Ne duhet të paraqesim shqiptarëve vizionin më të mirë. Zero tolerancë ndaj krimit të organizuar. U deklaroj këtu nga kjo sallë, organizatave kriminale të Elbasanit, të Durrësit, të Shkodrës dhe të mbarë Shqipërisë, se vend mbi tokë nuk do të keni përveç burgut. Jo.

Keni, keni dëmtuar rëndë qytetarët, qytetet, Shqipërinë. Jeni rreshtuar në mashë të një regjimi çnjerëzor. Ndaj dhe ne do jemi dhe do bëjmë gjithçka për sigurinë tuaj. Imagjini ju sot shefja, kryetarja e shërbimit informativ kombëtar, drejtori i përgjithshëm i policisë, drejtori i policisë, i laboratorit të policisë, e të tjerë të gjithë në një dosje me Edi Ramën.

Edhe një gjë do t'ju them, t'ju them një gjë këtu. Nuk janë asgjë ato mesazhe që shihni që tregojnë se çfarë llumi janë. Çfarë janë mesazhet e Edi Ramës në këto grupe? Kur i kërkoi dorëheqjen Lubi Ballukut në një seancë pesë orëshe në kryeministri në prani të Engjëll Agaçit dhe të ministrit të drejtësisë, ai thoshte jo, s'kam pse të jap dorëheqjen. Në fund i thotë ky, po ato mesazhet thotë, mesazhet thotë... ato janë lule, siç janë mesazhet tua aty thotë. Edhe ky u tërhoq menjëherë.

Ky u tërhoq menjëherë. Këta njerëz vërtet kanë vjedhur dhjetëra qindra milionë, por absolutisht që të gjitha aktet e tyre i kanë kryer me urdhër të Edi Ramës. Ndaj dhe gjërat kanë dalë. Është mençuria më e madhe e njeriut të ndahet nga e keqja. Nuk ka mençuri më të madhe se kjo.

Se e keqja mund të vijë edhe kur s'e don, edhe kur lufton kundër saj. Po një gjë është, vendimtar dhe përcaktuese për fatin tënd, vendimi yt për t'u ndarë nga e keqja. Dhe ne duhet të ndahemi nga kjo e keqe e madhe, duhet të ndahemi sa më shpejt. Demokratët duhet të jenë sot dhe do të jenë në krye të përpjekjes shqiptare për të ardhmen e vendit, për largimin e këtij regjimi.

Prej 120 ditësh qytetarët dhe të rinjtë shqiptarë zvarrisin Edi Ramën në rrugët e Tiranës, njëllor siç zvarritej dikur statuja e Enver Hoxhës. Tani u përket mbarë shqiptarëve, demokratëve, të ngrihen për të përmbushur këtë mision të madh, për të ripërtëritë Shqipërinë, për t'i rikthyer Elbasanit dhe Shqipërisë të ardhmen që meriton.

© SYRI.net

Lexo edhe:




'Maliqi nuk është hartë për t'u vizatuar nga lart'/ Alolli: Para se të ndryshoni hartën, përgjigjuni qytetarëve



'Rama jepe dorëheqjen!' Protestuesit nisin marshimin drejt Kryeministrit në qendresën e 118-të



VIDEO/ Berisha: Do shtojmë të paktën 40 bashki, 'do t'i japim përgjigjen përfundimtare këtij regjimi'



Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon Shqipërinë 2026



Çmimet stratosferike në Shqipëri, Kedhi: Jemi në një krizë të madhe, ekonomike, sociale e demografike



Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

TË NGJASHME



118 ditë rezistencë popullore – Skandalet e reja, protestuesit kërkojnë dorëheqjen e Ramës dhe qeverisë së tij



'Ngjyra blu, ngjyra e shpresës'/ Alizoti: Rrënja e mirë prodhon risi të mirë! PD ka nevojë për qëndrestarët dhe të rinjtë



VIDEO/ Berisha: Shqipëria ngjan me një të sëmurë në urgjencë, kërkon ndërhyrje të menjëhershme



Blanka Çopja: Partia Demokratike e kaloi oqeanin, tani duhet të jetë uragani që përmbys korrupsionin



VIDEO-‘Dyqanet plot, xhepat bosh’/
Berisha: Pensionistët nuk blejnë dot
ilaçet, regjimi i Ramës po shkatërron
Shqipërinë



‘Të mos ketë derë të mbyllur për të
rinjtë’/ Narazani: Ripërtëritja e PD ka
nisur, Elbasani është dëshmia



VIDEO/ Berisha: Vezë mbi Padrinon
në New York! Dënoj me forcë sharjet
e Ramës ndaj diasporës

[LAJME](#) [POLITIKË](#) [KRONIKË](#) [EKONOMI](#) [KOSOVA](#) [BOTË](#) [KULTURË](#) [SHKENCË](#) [SPORT](#) [JETË/STIL](#) [TRASHËGIMI](#) [MIEDIS](#) [ARKIVA](#)



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.